

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data 20..01.2022]

Drejtuar: 1. Operatori ekonomik ALCANI SHPK me nipt J91505006Q me adrese Tirane Kamez Blloku "Frutikulture", rruga e Laknasit, 100 m prane ures .

* * *

Procedura e prokurimit: Tender i hapur i thjeshtuar-mallra

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma 7.032.780(shtatemilionetridhjeteedymijeeshhtateqind etetedhjetete).Lek pa TVSH. Objekti Furnizim me lende djegese per ngrohje (briket pellet-Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (24 muaj”kohëzgjatja e kontratës, **24 muaj**.etj.] REF-16197-12-23-2021.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data 28.12.2021] [Numri 187]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. ALCANI SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

J91505006Q

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ 7.024.878(shtatemilionenjezetekatermijeeteteqindeshstatedhjetetete.Lek pa TVSH
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. LAURETA SULOLLARI PF-

Emri i plotë i shoqërisë

K42403003A

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ 0 (zero) nuk ka dorezuar oferte.

e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. LAURETA SULOLLARI PF-

K42403003A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

1. Nuk ka plotësuar kërkesat e përgjithshme për kualifikim.pikat:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

2. Nuk ka plotësuar kërkesat e veçanta për kualifikim ,pika 1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1 Nuk ka plotësuar kërkesat e veçanta për kualifikim kapacitetu profesional.**1.1)** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikatat e cilësisë së mëposhtme (të vlefshme) objekti i të cilave të jetë në përputhje me objektin e prokurimit:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- d) Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Dokumentacioni për vërtetimin e akreditimit të laboratorit të kërkuar më sipër do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues para lidhjes së kontratës ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)*
- e) Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë çertifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Nuk ka plotësuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti ekonomik dhe financiar 2.2.1)

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2. Nuk ka plotësuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti ekonomik dhe financiar 2.2.2)

Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Nuk ka plotësuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti ekonomik dhe financiar,pika

2.2.3) Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2021 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë

vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. *(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).*

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Nuk ka plotësuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika **2.3.1)** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..

2. Nuk ka plotësuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika **2.3.2)** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktin objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Nuk ka plotësuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika **2.3.3)** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 6 gjashtë) punonjësve, për periudhën korrik 2021–nentor 2021 dhe në vazhdim,nga te cilet 1 shofer kamjoni qe vertetohet me dokumentin CAP, nje mekanik i certifikuar per enet ne presion(kaldajat) dhe 2 punetore ngarkim shkarkimi dhe e dokumentuar kjo me vertetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj. *(Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues para lidhjes së kontratës, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)*

4. Nuk ka plotesuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika 2.3.4 Deklarate qe Operatori ekonomik qe kualifikohet fituesi duhet te montoje paisjet djegese te pelletit (kaldajat) nga data e fillimit te kontrates deri ne perfundimin e saj.Paisjet teknike (kaldajat dhe djegësi/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose në kontrata qeraje noteriale per gjithë periudhen e zbatimit te kontrates.

5. Nuk ka plotesuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika 2.3.5 Ofertuesi duhet te dorezoje, një deklaratë ku , të marrë detyrimin per riparimin e kaldajave dhe djegësit (bruciatori) në rast të ndonjë difekti të mundëshëm gjatë periudhës së zbatimit të kontratë

6.Nuk ka plotesuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika 2.3.6- Operatori ekonomik duhet te dokumentoje se ka gjendje 2 (dy) copë kaldaja per pellet (me fuqi 250-300 KW)dhe 2 (dy) cope kaldaje per pellet me fuqi 500-581 KW(sipas specifikimeve teknike shtojca 5 DST), te vertetuara me dokumenta (fatura tatimore shitje (tvsh) dhe/ose zhdoganimi) qe do te instalohen ne ambientet e spitalit Librazhd te cilat do te jene ne perdorim deri ne perfundim te kontrates nga autoriteti kontraktor. Paisjet teknike (kaldajat dhe djegësi/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose në kontrata qeraje noteriale per gjithë periudhen e zbatimit te kontrates

7.Nuk ka plotesuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika 2.3.7 Operatori ekonomik të paraqesë në mënyrë elektronike në sistem, fletë-analizën nga Laboratori i çertifikuar. të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për produktin objekt prokurimi me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara për vlerësimin e mostrës së mallit objekt prokurimi. me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Dëshmia me rezultatet e testeve zyrtare duhet të jetë lëshuar deri ne 3 muaj para dates se zhvillimit të tenderit. *(Dokumentacioni për vërtetimin e akreditimit të laboratorit të kërkuar më sipër do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues para lidhjes së kontratës, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)*

8.Nuk ka plotesuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika **2.3.8**) Operatori ekonomik ofertues, nëse nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar, të vlefshme, për produktin sipas objektit të prokurimit. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i i Autorizuar duhet të paraqitet një akt marrëveshje midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit, e vlefshme. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

9.Nuk ka plotesuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika **2.3.9**) Operatori ekonomik ofertues për realizimin në kohë të shërbimeve objekt të prokurimit duhet të ketë në pronësi ose mbështetje nga një operator ekonomik për të paktën 1 ATP (automjet i transportit të përzier) dhe 1 (një) automjet kamion vinç me kapacitet ngritës jo më pak se 1.5 (një pikë pesë) ton dhe kapacitet mbajtës jo më pak se 10 (dhjete) ton dhe nje Pirun ngrites per futjen e materialit ne magazinën e spitalit. Për këtë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin dhe dokumentacionin për vlefshmërinë e tahogرافit + çertifikatën e transportit të

mallrave për automjetin kamion vinç të vlefshme, ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë një deklaratë mbështetje nga një operator ekonomik ku të deklarohej se mbështetja e tij për këtë kapacitet teknik ofrohet për një afat sa kohëzgjatja e kontratës së parashikuar si dhe dokumentacionin shoqëruar për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin dhe dokumentacionin për vlefshmërinë e tahografit për automjetin kamion vinç + çertifikatën e transportit të mallrave) të vlefshme. Per Pirunin ngrites te vertetohet qe eshte ne pronesi te operatorit me ane te zhdoganimit ose fature TVSH.Për çdo automjet duhet të paraqitet foto ku të dallohet qartë lloji i automjetit dhe targa e tij. *(Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues para lidhjes së kontratës, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)*

10.Nuk ka plotësuar kerkesat e veçanta per kualifikim kapaciteti teknik,pika **2.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) deri ne 1 (nje) dite para hapjes së ofertave ne vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, (sekretarine e institucionit) nga jo më pak se një 1(një) kampion në paketim origjinal për produktin objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostra duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. ALCANI SHPK

J91505006Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ 7.024.878 (shtatë milion e njëzet e katër mijë e tetë qind e shtatëdhjetë e tetë lek pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra _____

Etj. _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

D R E J T O R I

Bledar Hima